

Nr. 3038 prot.

24.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT: AMENDIM NË PROJEKTLIGJIN “ PËR NJË SHITESË
DHE DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR.**

KËRKUES:

Znj. Monika Kryemadhi

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKTI:

“PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR”.

BAZA LIGJORE:

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:

Lidhur me këtë projektligj, mendoj se ndryshimet e propozuara nga qeveria shqiptare do të ndikojnë negativisht në mënyrë të pakthyeshme sektorin e bujqësisë dhe agropërpunimin bujqësor. Përpos faktit që qeveria nuk po i mbështet me subvencione fermerët dhe agropërpunuesit, ajo i rëndon më tej ata me taksa të pastudiuara financiarisht.

Më konkretisht kërkoj amendimin e nenit 1 të projektligjit të cituar në lëndë, nen i cili bën fjalë për ndryshimin e nenit 49 “Shkallët e reduktuar” të ligjit për TVSH , duke mos e miratuar atë.


Rritja e TVSH-së për inputet bujqësore me 10% do të ndikonte direkt në bujqësinë shqiptare duke i rënduar fermerët me pagesa shtesë dhe në të njëjtën kohë do të rëndonte edhe konsumatorin përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”,* paraqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e bujqësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënies së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

MONIKA KRYEMADHI



ANEKSI 1

Në projektligjin PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË" TË NDRYSHUAR të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Të shfuqizohet Neni 1.